



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 3658/prot
16

Tiranë, më 06 . 7 .2018

URDHËR

Nr. 437 , datë 06 . 7 .2018

“PËR

**LICENCIMIN E SHOQATËS “GRAMM-A” SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT
KOLEKTIV NË FUSHËN E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË
FONOGRAMEVE DHE VIDEOGRAMEVE”**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së shoqatës “GRAMM-A” për pajisje me licencë nr. 3658 prot., datë 28.5.2018, Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018 “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim /ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me Urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”;

URDHËROJ:

1. Licencimin e shoqatës “GRAMM-A” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve.
2. Afati i licencës është tre (3) vjet nga hyrja në fuqi e këtij Urdhri.
3. Pas botimit në Fletoren Zyrtare, të urdhrin të Ministrit të Kulturës për ripërtëritjen e licencës, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në vlerën prej 300.000 lekë, e parashikuar në Vendimin nr. 33, datë 18.1.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

4. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI

